



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 169 Datë 28.05.2020**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E DISA AUTOMJETEVE NGA GJYKATA E LARTË, PRANË  
GJYKATAVE TË TJERA DHE KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 95 e 96 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 03.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të Udhëzimit nr. 30, datë 30.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik” i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, si dhe në dokumentacionin e përgatitur për këtë qëllim nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e transferimit të 3 (tre) automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.
2. Miratimin e transferimit të 2 (dy) automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.
3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**Pasqyra e transferimit nga Gjykata e Lartë, në Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë dhe Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë**

*Pasqyra nr. 1,*

<b><i>Nr.</i></b>	<b><i>Tipi i automjetit</i></b>	<b><i>Viti prodhimit</i></b>	<b><i>Targa</i></b>	<b><i>Transferohet</i></b>
1	Mercedes Benz, tip 203	2005	TR 0268 Z	Gj. Apel Vlorë
2	Mercedes Benz, tip 203	2005	TR 0273 Z	Gj. Rr. Gj. Durrës
3	Mercedes Benz, tip 203	2005	TR 0274 Z	Gj. Rr. Gj. Kukës

**Pasqyra e transferimit nga Gjykata e Lartë, në Këshillin e Lartë Gjyqësor**

*Pasqyra nr. 2,*

<b><i>Nr.</i></b>	<b><i>Tipi i automjetit</i></b>	<b><i>Viti prodhimit</i></b>	<b><i>Targa</i></b>	<b><i>Transferohet</i></b>
1	Mercedes Benz, tip 205	Viti 2014	AA 857 OX	KLJGJ-ë
2	Wolswagen Passat	Viti 2011	AA 330 BO	KLJGJ-ë